



Pranimi / Dorezuar Priljepe / Profato Received / Delivery	29.12.2023	3	viti god year
Organ / Jedinica Org / Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shteti / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKUPSHK	7757	2023	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1439/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1439/2023 të datës 23.11.2023 të parashtruar nga ankuesja , kundër Konkursit me numër reference RN00012299 të shpallur më datë 10.08.2023 nga Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e parakohëshme ankesa me numër A.nr.1439/2023 e datës 23.11.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës në bazë në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 34 paragrafi (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës fillimisht më datë 10.08.2023 ka njoftuar për Konkursin me numër reference RN00012299, për emrin e grupit „Specialistë të Shkencave Shoqërore” për pozitën e punës „Zyrtar për shërbime Sociale” në Qendrën për Punë Sociale/Prishtinë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 31.08.2023 deri më datën 07.09.2023.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ku sipas njoftimit të datës 20.09.2023, të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, e njëjta i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe i është nënshtruar të gjitha fazave të rekrutimit (testimit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë), ku sipas njoftimit përfundimtar të kandidatëve të suksesshëm të shpallur nga platforma digjitale SIMBNJ, ankuesja nga ky proces rekrutimi është vlerësuar nga Komisioni Vlerësues me shtatëdhjetë e gjashtë e tetë (76.8) pikë të përgjithshme duke u renditur e gjashta (6) në listë.

Më datë 23.11.2023, përmes emailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ankuesja ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7075/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1439/2023, me pretendimin ankimor nuk është vlerësuar saktë dhe drejtë në pjesën e jetëshkrimit edhe për kundër faktit se me Vendimin e datës 03.11.2023 Komisioni Vlerësues në Komunën e Prishtinës e ka kthyer, pjesën e jetëshkrimit në rivlerësim nga gjashtë (6) pikë në shtatë e gjashtë (7.6) pikë dhe kërkon nga Këshilli që të kthejë edhe njëherë vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistës me gojë në rivlerësim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Komunën e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 04.12.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.11.2023 të parashtruar përmes emailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00012299 të shpallur me datë 10.08.2023; Njoftimin e datës 14.09.2023 të shpallur nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; Njoftimin e datës 29.09.2023 të shpallur nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; Njoftimin e datës 06.11.2023 të shpallur nga Komisioni Vlerësues; Njoftimin e datës 24.10.2023 të shpallur nga Komisioni Vlerësues; Kërkesën e datës 24.10.2023; Dëshmi nga portali SIMBNJ; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.11.2023; Përgjigjen në ankesë të 04.12.2023 të protokolluar me numër protokoll 1439/2023; Vendimin me numër 14-020/04-0197412/23 të datës 26.09.2023; Lista e aplikantëve; Renditja përfundimtare me numër reference RN00012299; Vendimin për Themelimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil me numër 14-020/04-37397/23 të datës 20.02.2023; Akt Emërimit me numër Nr.01-112-1127 të datës 15.05.2023; Akt Emërimit me numër Nr.05-55/94 të datës 08.02.2023; Akt Emërimit me numër Nr.01-112-517 të datës 01.01.2023; Akt Emërimit me numër Nr. 14-112/01-37333/20 të datës 08.02.2023; Formularët e vlerësimit për kandidatët fitues; Aplikacionin e ankueses Edlirë Kamberi me numër të shpalljes RN00012299 të datës 07.09.2023; Certifikatën mbi Dënimet Penale me numër Nr.ser. CIFA21B195AC422 të datës 05.09.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Letrën e referencës me NRB: 810051946 të lëshuar nga KIGA; Diplomën me Nr.prot.121 të lëshuar nga ShMM „Hysni Zajmi” më datë 14.06.2007; Dëftesën me Nr.00-06-021-1 të datës 24.06.2004; Dëftesën me Nr.00-06-021-1 të datës 03.06.2005; Dëftesën me Nr.00-06-021-1 të datës 03.06.2006; Dëftesën me Nr.00-06-021-1 të datës 29.06.2007; Diplomën me Nr.5354 të datës 29.11.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Hasan Prishtina; Aplikacionet e kandidatëve të suksesshëm për pozitën „ Zyrtar për Shërbime Sociale 2” Qendra për Punë Sociale/Prishtinë, së bashku me dëshmitë e bashkangjitura në aplikacion.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, ***është e parakohshme, sepse:***

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe mbi bazën provueshmërisë së ankesës së ankueses, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores



(QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 25 paragrafët 4, 5, dhe 6, ku përcaktohet se: "...4.Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje." si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së kandidatja e pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, fillimisht, duhet të ushtroj ankesë të brendshme të Komisioni i Pranimit, e me tej, pas marrjes se vendimit te organit te punësimit apo në raste të heshtjes administrative, mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke respektuar afatet ligjor sipas nenit 127 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, nisur nga ky fakt, rrjedhë së ankesa me numër A.nr.1439/2023, e parashtruar me datë 23.11.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1439/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.